NJOFTIM MBI LISTËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK PËR LËVIZJEN PARALELE NË KATEGORINË E ULËT DREJTUESE

Njësia përgjegjëse pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në zbatim të ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013 "Për nëpunësin civil", të ndryshuar, Kreut V "Lëvizja paralele dhe Ngritja në detyrë" dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 242, datë 18.03.2015 "Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese", të ndryshuar, njofton se në përfundim të afatit për pranimin e dokumenteve, si dhe verifikimit paraprak të kandidatëve, për përmbushjen e kushteve dhe kritereve të veçanta për lëvizjen paralele, të përcaktuara në shpalljen për konkurrim, deri në datën 16.11.2026, nuk është paraqitur asnjë kandidaturë/nuk ka kandidatë të kualifikuar për të vazhduar fazën e dytë të konkurrimit, për pozicionin:

1- **"Inspektor" 1 (një) në Drejtorinë e Mbikëqyrjes në Fushën e Drejtësisë Penale dhe Sigurisë Publike, në Drejtorinë e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, pranë KDIMDP-së**

   Kategoria III-1

Vëmendje: Njësia përgjegjëse do të njoftojë nëpërmjet faqes zyrtare të KDIMDP-së të gjithë kandidatët që kanë aplikuar deri në datën 20.11.2026, për procedurën e ngritjes në detyrë, mbi listën e kandidatëve që kanë plotësuar kriteret për të vazhduar fazën e dytë të vlerësimit, datën dhe vendin ku do të zhvillohet konkurrimi.

Njësia Përgjegjëse